



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E FINANCËS, PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË
ASETEVE

Nr. 4539 Prot

Himarë, më 19.06 2026

Lënda: Dërgohet projektvendimi dhe projektbuxheti për disa ndryshime buxhetore mbi buxhetin e vitit 2026.

KËSHILIT TË BASHKISË HIMARË
SEKRETARISË SË KËSHILLIT BASHKIAK ✓

KËTU

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat vetëqeverrisjes vendore”, dhe udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë për përgatitjen e buxhetit vendor;

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- 1- Projektvendimin për miratimin e disa ndryshimeve buxhetore te vitit 2026.
- 2- Projektbuxhetin e ndryshimeve buxhetore 2026.

Duke ju falanderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E FINANCËS, PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË
ASETEVE

Nr. 1539/1 Prot

Himarë, më 19.06.2026

PROJEKTVENDIM

Nr. 39 Datë 19.06.2026

**“PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE BUXHETORE MBI BUXHETIN E VITIT
2026”**

Mbështetur në nenet 34,40,41,45,55 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 9936 datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 të ligjit Nr 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore” ligjin Nr 10296 datë 08.07.2010. “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave “Mbi procedurat standarte të miratimit të buxhetit”, të ndryshuar, mbi njoftimin për transfertën e pakushtëzuar e përgjithëshme dhe sektoriale, për vitin 2026;

VENDOS:

1. Të miratohen ndryshimet buxhetore mbi buxhetin e vitit 2026.
2. Drejtoria e financës, planifikimit të buxhetit dhe menaxhimit të aseteve, sektori i financës, autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Keshilli Bashkiak sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave .
3. Ndryshimet të pasqyrohen në PBA 2027- 2029.

DREJTOR I DREJTORISË

Besa Xhaferi



KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

**DREJTORIA E FINANCËS, PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË
ASETEVE**

Nr. 1539/2 Prot

Himarë, më 19.06.2026

PROJEKTBUXHET I NDRYSHIMEVE BUXHETORE 2026

Tabela e lëndës

KAPITULLI I: INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2026 DHE NDRYSHIMET	2
KAPITULLI II. RIVLERËSIMI I TË TE ARDHURAVE TË BASHKISË HIMARË.....	3
KAPITULLI III. SHPENZIMET E BASHKISË HIMARË MBI TË ARDHURAT E PARASHIKUARA	5
SHPENZIMET PER PAGAT DHE SIGURIMET SHOQËRORE.....	6
DETYRIMET E PRAPAMBETURA DHE INVESTIMET NË VAZHDIM NË BUXHETIN FAKTIK	6
SHPENZIMET OPERATIVE TË BUXHETIT FAKTIK 2026	7
SHPENZIMET KAPITALE SHITESË DHE RIVLERËSIME	8

KAPITULLI I: INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2026 DHE NDRYSHIMET

Në bazë të ligj Nr.9936, datë 26.6.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 139/2015 neni 16 pika, ligjit Nr. 68, datë 27.04.2017 “Per financat e vetëqeverisjen vendore”, Bashkia Himarë vlerëson të ardhurat e realizuara deri në këtë periudhë si dhe faktorët e tjerë makroekonomik të publikuara nga institucionet përkatëse. Gjithashtu bazuar në nevojat dhe prioritetet e komunitetit si dhe politikat zhvillimore, bën shpërndarjen e të ardhurave shtesë ose rialokimeve të ndryshme për shkak të faktorëve ndikues gjatë kësaj periudhe. Dis nga faktorët kryesorë të cilët çojnë në nevojshmërinë e këtyre ndryshimeve buxhetore janë:

- a) Realizimi i të ardhurave tatimore dhe jotatimore bazuar në parashikimet e fundit buxhetore.
Gjatë zbatimit të buxhetit, Bashkia monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e realizimit të të ardhurave tatimore dhe jotatimore, duke e krahasuar atë me parashikimet e miratuara në buxhetin fillestar. Analiza periodike e treguesve financiarë mund të evidentojë nivele realizimi më të larta ose më të ulëta se ato të planifikuara, si rezultat i ndryshimeve në aktivitetin ekonomik, përmirësimit të performancës së mbledhjes së të ardhurave, zgjerimit të bazës së tatimpaguesve, ndryshimeve ligjore apo faktorëve të tjerë ekonomikë dhe socialë. Në këto kushte, lind nevoja për rishikimin e planit të të ardhurave dhe për pasojë edhe të shpenzimeve buxhetore, në mënyrë që buxheti të reflektojë sa më saktë kapacitetin real financiar të Bashkisë, duke garantuar një përdorim efikas, transparent dhe të qëndrueshëm të burimeve publike në funksion të përmbushjes së prioriteteve dhe nevojave të komunitetit.
- b) Rivlerësime të projekteve të propozuara nga buxheti paraardhës nga ana teknike e tyre.
Gjatë fazës së zbatimit dhe përgatitjes së procedurave të prokurimit, projektet e miratuara në buxhetin paraardhës mund t'i nënshtrohen rivlerësimeve teknike, të cilat lidhen me përditësimin e preventivave, ndryshimin e volumeve të punimeve, përshtatjen me standardet teknike në fuqi, rezultatet e studimeve të mëtejshme inxhinierike, si dhe nevojën për ndërhyrje shtesë që nuk kanë qenë të identifikuar në momentin e planifikimit fillestar. Këto rivlerësime mund të sjellin rritje ose ulje të kostove të projekteve, duke krijuar nevojën për rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve ose zërave buxhetorë me qëllim garantimin e zbatimit të tyre në përputhje me kërkesat teknike dhe interesin publik.
- c) Financime shtesë nga institucione qendrore lidhur me projekte të miratuara nga buxheti paraardhës.

Gjatë vitit buxhetor, Bashkia mund të përfitojë financime shtesë nga institucionet e qeverisjes qendrore, fondet e zhvillimit rajonal, ministritë e linjës ose programe të tjera mbështetëse për projekte që janë parashikuar ose kanë nisur në buxhetin paraardhës. Këto financime ndikojnë në strukturën e buxhetit vendor dhe kërkojnë reflektimin e tyre përmes ndryshimeve buxhetore, me qëllim evidentimin e burimit të financimit, rritjen e fondeve përkatëse dhe mundësimin e realizimit të projekteve sipas afateve dhe objektivave të përcaktuara.

d) Të tjerë faktorë të paparashikuar.

Ndryshimet buxhetore mund të ndikohen edhe nga faktorë të tjerë të paparashikuar, të cilët nuk kanë qenë të njohur ose të vlerësueshëm në momentin e hartimit të buxhetit. Këta faktorë mund të përfshijnë emergjenca civile, fatkeqësi natyrore, ndryshime në kuadrin ligjor dhe nënligjor, vendime të organeve qendrore, luhatje të çmimeve në treg, nevoja urgjente për mirëmbajtje ose investime publike, detyrime të krijuara nga procese gjyqësore, si dhe situata të tjera që ndikojnë drejtpërdrejt në realizimin e funksioneve dhe përgjegjësi të Bashkisë. Në këto raste, bëhet e nevojshme rialokimi i fondeve ose përdorimi i të ardhurave shtesë për të garantuar vazhdimësinë e shërbimeve publike dhe përmbushjen e objektivave të zhvillimit vendor.

KAPITULLI II. RIVLERËSIMI I TË TE ARDHURAVE TË BASHKISË HIMARË.

Gjatë përgatitjes së buxhetit të vitit 2026, janë marrë konsideratë të gjithë faktorët makroekonomik, situata e përgjithëshme vendore, rajonale dhe shtetërore duke pasur si fokus parashikimin sa më realist të të ardhurave për vitin në vijim. . Ndër faktorët e përdorur mund të përmendim rritjen reale ekonomike, normën e inflacionit si dhe parashikime nga institucione qendrore is Banka e Shqipërisë, INSTAT por edhe burime informacioni nga agjentë të tjerë.

Duke krahasuar të ardhurat e parashikuara me ato të realizuara, nga aktrakordimi kumulativ i fundit i bashkisë me degën e thesarit Vlorë, rezulton se disa nga të ardhurat tatimore janë realizuar ose edhe tejkaluar që në këtë periudhë. Ndër to mund të përmendim Taksa e Nderteses, Taksa e Truallit, Taksa e Fjetjes ne Hotel, Takse Reklame, Tarife Pastrimi , Tarife Per Zenien e Hapsires Publike ku realizimi i tyre paraqitet në tabelën e mëposhtëme.

Nr.	Emrtimi i të Ardhurës	% realizimi 5-mujorin e parë
1	Taksa e Nderteses	21.68%
2	Taksa e Truallit	118.74%
3	Taksa e Fjetjes ne Hotel	26.04%
4	Takse Reklame	40.03%
5	Tarife Pastrimi	26.94%
6	Tarife Per Zenien e Hapsires Publike	123.82%

(Tabela 1.0)

Nga pasqyra e mësipërme, vërehet se krahas të ardhurave të tjera të cilat po shkojnë sipas planit të mëparshëm, këto të ardhura janë realizuar mbi pritshmëritë çka krijon konfidencën e rritjes së realizimit të të ardhurave të parashikuara sipas tabelës së mëposhtëme.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e të ardhurave

(Në mijë lekë)

Nr	Emertimi i te Ardhurave Tatimore	QERSHOR 2026
I.	Te ardhura nga taksa	5,070,700
1	Taksa Vjetore e Mjeteve te Perdorura	5,000
2	Taksa mbi kalimin e te drejtes se Pronesise	30,000
3	Taksa mbi Renten Minerare	1,200
5	Tatimi i te ardhurave personale	3,500
6	Taksa e Nderteses	65,000
7	Taksa e Truallit	15,000
8	Taksa e Tokes Bujqesore	4,500
9	Taksa e Ndikimit ne Infrastruktura	4,899,000
10	Taksa e Fjetjes ne Hotel	40,000
11	Taksa te Perkohshme	4,000
12	Takse Reklame	3,000
13	Takse Tabele	500
II.	Te ardhura nga tarifat	685,000
1	Tarife Pastrimi	130,000
2	Tarife Gjelberimi	11,000
3	Tarife Ndricimi	11,000
4	Tarife Per Zenien e Hapsires Publike	300,000
5	Tarifa per Leje Ndertimi	200,000
6	Tarife per Sherbime Komunale	5,000
7	Tarifa per Sherbime Administrative	8,000

9	Tarife Parkimi	3,000
10	Tarife Leje Licenca	5,000
11	Gjoha dhe kamatevonesa tatimore	12,000
III. Te ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qera		10,000
1	Shitje te Pasurive te Paluajtshme	
2	Qira Ndertesa	1,000
3	Qira Troje	4,000
4	Qira Kullota	5,000
IV Te ardhurat gjithsej (I+II+III)		5,765,700
1	Te ardhura te trashëguara nga 2025	3,550,214
2	Te ardhura nga debitor te prapambetur	60,000
3	Te ardhura nga transfera e pakushtezuar e pergjithshme	221,935
4	Te ardhura nga granti i pakushtezuar sektorial	81,061
5	Transfera Specifike	29,505
6	Granti specifik Mbrojtja Civile	
7	Te ardhura me financim te Huaj	6,111
Totali		9,714,526

(Tabela 2.0)

Në prezantimin e projektvendimit të buxhetit faktik për vitin 2026, kemi parashikur ndryshime në parashikimin e të ardhurave të Bashkisë Himarë, si me të ardhurat e veta apo nga grantet e qeverisjes qëndrore.

KAPITULLI III. SHPENZIMET E BASHKISË HIMARË MBI TË ARDHURAT E PARASHIKUARA

Bazuar në parashikimin e të ardhurave, bashkia ka bërë shpërndarjen e tyre në bazë të nevojave dhe kërkesave ligjore përkatëse. Totali i shpenzimeve të parashikuara do të jetë i barabartë me totalin e të ardhurave të parashikuara për vitin 2026.

Nga rakordimet me degën e thesarit Vlorë, në lidhje me detyrimet e prapambetura, u bënë sistemimet përkatëse duke evidentuar të gjitha detyrimet e prapambetura. Shpenzimet e kryera deri në fund të kësaj periudhe janë pasqyruar në këto ndryshime.

Duke llogaritur të ardhurat e shtuara përkundrejt shpenzimeve, nga rakordimi me degën e thesarit Vlorë, është bërë gjithashtu balancimi i totalit të të ardhurave të parashikuara me atë të shpenzimeve të parashikuara.

SHPENZIMET PER PAGAT DHE SIGURIMET SHOQËRORE

Nisur nga ndryshimet e fundit strukturore të kërkuara nga sektori përkatës lidhur me shtimin e stafit për nevoja të zgjerimit të kapacitetit të shërbimit të çerdhes me drekë, shpenrimet për programin 09120 “Arsimi Parashkollor” do të rriten në vlerë reale për llogaritë ekonomike 600, 601 (paga dhe sigurime shoqërore) nga 24,395,000 lekë në total në 26,385,204 pra një rritje me 1,990,204 lekë.

Shpenzimet e parashikuara për pagat dhe sigurimet shoqërore për administratën e Bashkisë dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve nuk do të ndryshojnë.

DETYRIMET E PRAPAMBETURA DHE INVESTIMET NË VAZHDIM NË BUXHETIN FAKTIK

Detyrimet e prapambetura, si tëtësi e mallrave, shërbimeve dhe investimeve të pagueshme në vitin korrent 2026, përbëjnë një pjesë tjetër të rëndësishme të buxhetit. Me rakordimet e buxhetit faktik 2026 ku në të cilinin përfshihen të gjitha ato pagesa të likujduara për llogari të vitit 2026 deri në këtë periudhë, rezultojnë disa diferenca për kontrata të cilat nuk ishin angazhuar në sistemin e pagesave elektronike. Nga vlera totale e fundit e ketij zëri e cila ishte 2,028,634 (mijë) lekë, ajo shkon në 2,111,188 (mijë) lekë. Më poshtë paraqiten me detaje shtesat tek ky zë i shpenzimeve buxhetore.

EMERTIMI	Ishte	Bëhet
SHPENZIME MBYKQYRJE PUNIMESH	0,00	6,568,601
Shpenzime per trajnimin e keshillit bashkiak	149,520.00	0.00
Rikonstruksioni i rruges Hore Vranisht-Vranisht	9,802,397.00	44,500,000
“Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara” (2025)	568,538.00	1,507,011
RËKONSTRUKSIONI I RRUGES VUMBLO - PILUR	197,319,150.20	227,352,529.20
RIKONSTRUKSIONI I RRUGES SE ATHALIT	227,002,827.80	234,040,054.80
Mirembejtje gjelberimi	0,00	3,427,627

(Tabela 3.0)

Këto shtesa dhe pakësime plotësojnë tabelën e detyrimeve të prapambetura dhe investimeve në vazhdim, miratuar me vendimin e fundit të Këshillit Bashkiak Himarë.

SHPENZIMET OPERATIVE TË BUXHETIT FAKTIK 2026

Shpenzimet operative (llog 602) janë tërësia e mallrave dhe shërbimeve të cilat paguhen në vitin korrent. Nisur nga kërkesat buxhetore të njësisve shpenzuese, si në për sa i përket bashkisë por edhe ndërmartjes së varësisë, në tabelën e mëposhtëme paraqiten shtesat për zërin mallra dhe shërbime operative si dhe transferta korrente të jashtëmë (konkretisht llog ekonomik 602-604). Tabela e mëposhtëme paraqet vlerat e ketyre zërave të shpenzimeve për buxhetin faktik të 2026.

Llog.ek	Emertimi	Vlera Totale e Shpenzimit	QERSHOR 2026
602	Shpenzime per sherbime auditimi	1,000	1,000
602	Blerje uniforma per policine bashkiake	1,500	1,500
604	Mbeshtetje per aktivitetin "Vizioni Blu i Himarë"	12,000	12,000
604	Mbeshtetje per aktivitetin "Santa is coming to Himara"	9,250	9,250
604	Mbeshtetje per aktivitetin "Përtej Ekranit"	6,000	6,000
604	Mbeshtetje per aktivitetin "Tepër e bukur për t'u ndotur"	8,000	8,000
604	Mbeshtetje per aktivitetin "Designing Himara"	10,050	10,050
604	Mbeshtetje per aktivitetin "Një histori nga vendi im"	3,000	3,000
604	Mbeshtetje per aktivitetin "Himara Valart"	6,015	6,015

(vlerat në mijë lekë) (Tabela 4.0)

Mbështetja financiare e organizatave jofitimprurëse (OJF) që zhvillojnë aktivitete kulturore, artistike dhe zhvillimore përbën një instrument të rëndësishëm për promovimin e identitetit lokal, trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit të qëndrueshëm të komunitetit në territorin e Bashkisë Himarë. Përmes veprimtarive të tyre, këto organizata kontribuojnë në pasurimin e jetës kulturore dhe sociale, rritjen e pjesëmarrjes qytetare, promovimin e turizmit kulturor, mbështetjen e talenteve të reja, si dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe komunitetit. Financimi i aktiviteteve të tilla krijon mundësi për organizimin e ngjarjeve me ndikim pozitiv ekonomik dhe social, duke rritur atraktivitetin e zonës dhe duke kontribuar në realizimin e objektivave strategjike të zhvillimit vendor të Bashkisë Himarë.

Konkretisht në këto shtesa buxhetore paraqiten projektet e mëposhtëme për financim;

Tabela e mëposhtëme sqaron edhe listën e OJF-ve të cilat lidhen me aplikimet për projekte dhe bashkëfinancime të bashkisë.

Emertimi i aktivitetit	Emri Ligjor I Organizatës Jofitimprurëse
Mbeshtetje per aktivitetin "Vizioni Blu i Himarë"	Qendra "Education For Change"
Mbeshtetje per aktivitetin "Himara Valart"	Shoqata Art Impulse
Mbeshtetje per aktivitetin " Santa is coming to Himara"	Vizion i ri 2016 (New) Vision 2016)
Mbeshtetje per aktivitetin "Përtej Ekranit"	Qendra "Edukojme me Art"
Mbeshtetje per aktivitetin "Tepër e bukur për t'u ndotur"	Center for Entrepreneurship & Innovation
Mbeshtetje per aktivitetin " Designing Himara"	Qendra "ORBIS"
Mbeshtetje per aktivitetin "Një histori nga vendi im"	Qendra Kombëtare për Zhvillim Ekonimiko Social (NCSED)

(Tabela 5.0)

Gjithashtu në bazë të kërkesave për aktivitetet të cilat bashkia bashkëfinancon, janë paraqitur kërkesat e mësipërme (llogarite 604) të cilat shërbejnë për mbështetje të zhvillimit të jetës artistike dhe kulturore si dhe në shërbim të promovimit të turizmit në Himarë. Bazuar në kërkesat e subjekte jofitimprurëse janë renditur të dhënat e aplikimeve.

SHPENZIMET KAPITALE SHITESË DHE RIVLERËSIME

Gjatë fazës së hartimit të projekteve të zbatimit, nga matjet në terren si dhe nga vlerësimet e ndryshme ligjore të kërkuara, u hasën disa problematika me projekte të cilët kërkojnë shtesa dhe/ose pakësime fondesh. Këto ndryshime pasqyrohen në tabelën e mëposhtëme përmbledhëse:

(të dhënat në mijë lekë)

Prog	Ilog	Planifikimi i "Shpenzimeve Kapitale" per vitin 2026 (Llog. 230-231 - Investime)	Vlera Totale e Investimit	Qershor	Pagesa	Pagesa
				2026	per Vitin 2027	Per vitin 2028
		Planifikimi menaxhimi dhe Administrimi				
1110	230	Studim mbi eficiencen e godinave publike te bashkise himare	35,000	35,000		
01110	231	Zhvillimi i godines se bashkise faza e III	110,000	40,000	70,000	
01110	231	Mobilimi i godinës së re të bashkisë	53,000	53,000		

01110	231	Mobilimi i godinës së kopshtit	14,000	14,000		
		Sherbimet e policise vendore				
03140	231	Vendosje e sistemit te kamerave ne godinat publike dhe kryqezime kryesore	20,000	20,000		
			-			
		Mbeshtetje per zhvillim ekonomik	-			
04130	231	Ndertimi i impiantit fotovoltaik te Bashkise Himare	115,000	30,000	85,000	
			-			
		Rrjeti rrugor rural	-			
04520	231	Ndertimi i ures se varur panoramike Dhermi-Gjilek	-			
04520	231	Rikonstruksioni i rruges paralele me pedonalen e Dhermiut dhe trotuar	106,000	50,000	56,000	
04520	231	Ndertimi i rruges se re qe lidh rrugen nacionale me parkingun publik (stadiumi)	150,000	30,000	120,000	
04520	231	Rikonstruksioni i rruges Pilur-Kuç	-			
04520	231	Rikonstruksioni i rruges lidhese Konopice - Shen nikolle lot I	200,000	200,000		
04520	231	Rikonstruksioni i rruges pararele me shetitoren e plazhit, Borsh	400,000	50,000	250,000	100,000
04520	231	Ndricimi dhe trotuar i rruges lagje haliq Borsh lot	13,650	13,650		
		Planifikimi urban vendor	-			
06140	231	Rikualifikimi i qendres dhe fasadave te objekteve ne kala, Himare fshat	500,000	10,000	270,000	220,000
06140	231	Rehabilitimi i fasadave te fshatit Dhermi loti II	600,000	100,000	300,000	200,000
06140	231	Rehabilitimi i kalldremeve ne Qeparo fshat	25,000	25,000		
06140	231	Rehabilitimi i kalldremeve ne fshatin Piqeras lot II	30,000	30,000		
			-			

		Sherbimet publike vendore	-			
06260	231	Ndertimi i shetitores se borshit lot i dhe lot II	2,000,000	459,141	540,859	1,000,000
06260	231	Ndertimi i parkimit ne qender te fshatit Vuno	23,800	23,800		
			-			
		Furnizimi me uje dhe kanalizime	-			
06370	231	Rehabilitimi i kanaleve vaditese	120,000	20,000	100,000	
06370	231	Ndertimi i kuz Borsh	600,000	50,000	300,000	250,000
		Sport dhe argetim	-			
08130	231	Ndertimi i pallatit te sportit Himare	120,000	20,000	100,000	
			-			
		Trashegimia kulturore, evente artistike kulturore	-			
08220	231	Rik i ujesjellesit te vranishtit (monument kulture)	-	-		
			-			
		Arsimi baze perfshir arsimin parashkollor	-			
09120	231	Rikonstruksioni i shkolles se mesme "Spiro Gjikhuri"(bashkeginancim)	20,000	20,000		
			-			
		Strehimi social	-			
10661	231	Ndertimi i banesave sociale	270,000	50,000	220,000	
10661	231	Blerje toke per ndertimin e banesave sociale	13,000	13,000		
10661	231	Restaurimi i banesave te familjeve ne nevoje	75,000	55,000	20,000	
		Totali	5,613,450	1,411,591	2,431,859	1,770,000

(Tabela 6.0)

Ndër projektet të cilët përmenden në tabelën e mësipërme do të veçjmë ato të cilën nuk do të financohen më nga buxheti i bashkisë : “Ndertimi i ures se varur panoramike Dhermi-Gjilek”, “Rikonstruksioni i rruges Pilur-Kuç” dhe “Rikonstruksioni i ujesjellesit te Vranishtit (monument kulture)”. Për projektin e parë, gjatë fazës së projektimit paraprak, grupi i projektimit

ka hasur vështirësi lidhur me statusin ligjor të fshatit Dhërmi si zonë e mbrojtur kulturore, në bazë të VKM Nr.29 dt 20.01.2026. Për këtë arsye hartimi i dokumentit të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) nuk është mundur të miratohet. Kështu ky projekt nuk mund të ketë vlerë ligjore. Për sa i përket projektit “Rikonstruksioni i rruges Pilur-Kuç”, ky projekt do të financohet nga Fondi Shqipëtar i Zhvillimit dhe projektit “Rikonstruksioni i ujesjellesit të Vranishtit (monument kulture)” që do të financohet nga Këshilli i Qarkut Vlorë, nuk nevojitet angazhimi i mjeteve financiare të bashkisë.

Gjithashtu janë kryer ristrukturime në shpërndarjen dhe alokimin e fondeve bazuar në tavanet buxhetore të PBA 2027-2029, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

		BUXHETI
Shpenzime per Paga dhe sig TOT	600-601	302,667,204.00
Mallra dhe sherbime	602	328,779,460.00
Transferta Korrente te Brendeshme	604	171,151,000.00
Investime per vitin 2026	230-231	5,723,135,021.00
Fondi I vecante mbi fondin e Pagave	606	9,000,000.00
Fondi i Emergjencave Civile(bashkia)		45,000,000.00
Fondi i Emergjencave civile (qeveria qendrore)		15,000,000.00
Fondi Rezerve		12,600,000.00
Fondi I Kontigjences		12,600,000.00
Investime ne Vazhdim dhe detyrime (Investime)	230/231	2,071,323,527.00
Sherbime ne Vazhdim dhe detyrime (Sherbime)	602	39,864,550.00
TOTALI BASHKIA		8,731,120,762.00
TOTALI I NSHP		983,405,842.00
	TOT I SHPENZIMEVE	9,714,526,604
	TOT TE ARDH	9,714,526,604.00

(Tabela 7.0)

Buxheti i bashkisë është i balancuar në zbatim të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 9936 datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-40 te ligjit Nr 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore” ligjin Nr 10296 datë 08.07.2010. “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 të Ministrisë së Financave “Mbi procedurat standarte te miratimit te buxhetit”, të ndryshuar, mbi njoftimin për transfertën e pakushtëzuar e përgjithëshme dhe sektoriale, për vitin 2026,” në vlerën totale të të ardhurave **9,714,526,604** lekë dhe të shpenzimeve totale **9,714,526,604** sipas tabelës së mësipërme.

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo

